

KONTRATE THEMELIMI
I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“UPlan ” SH.P.K.

Sot me date 05.04.2023, ne Tirane, me vullnetin tim te lire une i nenshkruari : Petraq Basha, i biri i Ligorit, i datelindjes 29.08.1979, lindur ne Fier te rrethit Fier dhe banues ne Tirane rruga “Sami Frasheri”, ndertesa 30, hyrja 2, apt.14, Tirane, mbajtes i leternjoftimit nr.personal H90829015C, me date leshimi 22.09.2022, i shtetesise Shqiptare.

Ne zbatim te Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” ,

Neni 1

Vendosa te themeloj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“UPlan” shpk.**

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Kryerjen e veprimtarise ne fushen e import-eksportit: makineri industriale dhe ndertimi, pajisje elektrike dhe elektronike, automjete te rinj dhe te perdorur, materiale bujqesore dhe ushqimore, fruta-perime, pjese kembimi, goma, bateri, punime druri dhe mobilje, duralumini, metalike, konfeksione.

Shoqeria mund te ushtroje cdo veprimtari tjeter tregtare dhe prodhuese e cila nuk ndalohet me ligj. (Neni 7 i Ligjit 9901, date 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”).

Neni 3

Ortaku themelues i shoqerise eshte **z. Petraq Basha.**

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqërisë është ne vleren e 100.000 leke (njqindmije), perbehet nga një kuota ne pronesi te:

- ✓ Ortakut te vetem z. Petraq Basha, nje kuote ne vleren e 100,000 leke ose 100%, te kapitalit themeltar te shoqerise,



Neni 5

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rruga "Sami Frasheri", ndertesa 30, hyrja 2, apt.14,
Bashkia Tirane.

Neni 6

Kohezgjaria e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe dhe fillon qe nga momenti regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 7

Administrator i shoqerise do te jete z. Petraq Basha, i cili do te qendroje ne kete detyre per 5 vite, me te drejte rizgjedhie dhe eshte i ngarkuar te kryeje akte dhe marre angazhime qe jane ne perputhie me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 8

Personaliteti juridik i shoqerise fitohet me regjistrimin e sajë ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Biznesit. Aktiviteti i sajë do te filloje pas kryerjes se procedurave ligjore. Ne aktivitetin e shoqerise do ti permbahemi statutit te hartuar per kete qellim dhe do te respektoj legjislacionin ne fuqi. Kjo kontrate themelimi u redaktua ne kater kopie, me vlerë te njejte ligjore, nje kopie dorezohet prane Qendres Kombetare te Biznesit , dhe nga nje kopie ortaket themelues te shoqerise.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE “

” SH.P.K.

Petraq BASHA

